



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:120475

Datë: 20.12.2021

Numri i dokumentit: 02528748

C.nr.867/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Afijete Sada - Gillogjani, në çështjen juridike të paditëseve 1. V. B. nga Gjakova, 2.V. V nga Gjakova dhe 3.V. Z. nga Gjakova, që të gjitha të përfaqësuar nga Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, kontest pune - për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera kontestit 1,644.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor – publik të mbajtur me 22 nëntor 2021, në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe në mungesë të paditurës, me 20 dhjetor 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses V. B. nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit të parave për praninë në punë, për periudhën kohore 29 nëntor 2019 – 05 nëntor 2021, për gjithsejtë 274 ditë pune, t'ia paguajë shumën prej 548.00 euro (pesëqind e katër dhjetë e tetë euro) dy euro për secilën ditë pune, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor e cila fillon të rrjedhë nga data 22 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, e këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses V. V nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit të parave për praninë në punë, për periudhën kohore 29 nëntor 2019 – 05 nëntor 2021, për gjithsejtë 274 ditë pune, t'ia paguajë shumën prej 548.00 euro (pesëqind e katër dhjetë e tetë euro) dy euro për secilën ditë pune, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data 22 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, e këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

III. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses V. Z. nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit të parave për praninë në punë, për periudhën kohore 29 nëntor 2019 – 05 nëntor 2021, për gjithsejtë 274 ditë pune, t'ia paguajë shumën prej 548.00 euro (pesëqind e katër dhjetë e tetë euro) dy euro për secilën ditë pune, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data 22 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, e këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, që paditëseve V. B. nga Gjakova, V. V nga Gjakova dhe V. Z. nga Gjakova, të iu kompensojë shpenzimet procedurale në lartësi prej 498.40 euro (katërqind e nëntë dhjetë e tetë euro e katër dhjetë cent), në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditëset me padi, parashtrësë dhe përmes të autorizuarit të tyre, kanë parashtruar se janë të punësuar tek e paditura dhe kanë punuar pa ndërprerje që nga viti 2019 dhe tutje atë në shkollën “Mustafa Bakija ” në Gjakovë, siç provojnë me kontratat e punës dhe listat e pagave për vitin 2021. E paditura që nga data 20 nëntor 2019 e tutje ka pasur obligim që paditësve të iu kompensojë shumën prej dy (2) euro për çdo ditë pune, e kjo në emër të shujtave. E paditura nuk e ka bërë këtë. Baza juridike e këtij kontesti lëndor që i referohet shujtës ditore, është detyrim që për të paditurën buron nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, datë 18 prill 2017. Paditëseve bazuar tek Kontrata 2021, iu është njohur e drejta për shujtën ditore prej dy (2) euro për një ditë pune. Paditëset përpos kompensimit të borxhit (kryegjësë), kërkojnë edhe kamatën ligjore prej 8 % në nivel vjetor sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa në kuptim të nenit 305 të LMD-së, këtu e paditura ka rënë në vonesë me mos përmbushjen e detyrimit, prandaj paditëset përmes kësaj padie, kërkojnë kamatën. Deri tek iniciimi i këtij kontesti ka ardhur si rezultat i mos gatishmërisë së të paditurës që ta përmbush detyrimin e vet në mënyrë vullnetare, ashtu që nga të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 264, dhe me nenin 79 të Ligjit të Punës, e të gjitha këto në lidhje me nenin 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, kanë kërkuar nga gjykata që pas shqyrtimit të provave të vendosë meritorisht lidhur me kërkesën e paditëseve.

I autorizuari i paditëseve ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv dhe si rrjedhim, me padinë burimore është thënë se paditëset kanë qenë të pranishme në pune për gjithsejtë 150 ditë. Kështu, në bazë të shkresës së lëshuar nga SHF “Mustafa Bakija” Gjakovë, ku paditëset janë të sistemuara, rezulton se të njëjtat kanë punuar për gjithsejtë 274 ditë. Gjatë shqyrtimit përgatitor i autorizuari i paditëseve ka mbetet pranë padisë dhe parashtrësës për rregullimin e padisë, datë 08 nëntor 2021, me të cilën është bërë zgjerimi i kërkesëpadisë, në aspektin objektiv. E paditura nuk ka ushtruar përgjigje në padi dhe nga kjo konkludojmë se e njëjta nuk e ka kundërshtuar asnjë pretendim të paditëseve. Nga provat e administruara në këtë çështje juridike në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën t’ a aprovojë sipas precizimit të bërë.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksë gjyqësore shumën 20.00€, përpilimin e padisë në shumë 208.00€, si dhe përfaqësimin në seancën përgatitore në shumë j 270.40€ e të gjitha këto në lartësi të përgjithshme 498.40€.

Të paditurës Gjykata ia ka proceduar aktvendimin e datës 18 tetor 2021 padinë dhe provat për të dhënë përgjigje në padi të cilat i ka pranuar me datë 27 tetor 2021 që vërtetohet nga fletë kthesa në lëndë, por e njëjta nuk ka vepruar.

Shqyrtimin përgatitor të treguar me datë 22 nëntor 2021 Gjykata e ka mbajt në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt dhe me propozimin e të autorizuarit të paditësve dhe në kuptim të nenit 409 paragrafi 2 të LPK-së.

Gjatë shqyrtimit Gjykata ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontratën e punës datë 01 shtator 2016, leg.nr.1873/21 datë 21 gusht 2021, letërnjoftimit ID . . . lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, për paditësen V. B., Kontrata e punës e datës 01 shtator 2015 leg, nr, 1227/2021 datë 31 mars 2021, letërnjoftimi nr. . . . MPB Republika e Kosovës për paditësen V. V., Kontrata e punës datë 01 shtator 2016, leg.nr.1199/2021 datë 30 mars 2021, letërnjoftimi nr. ID . . . MPB Republika e Kosovës për paditësen V. H. Z., lista e pagave e muajit mars 2021, vërtetimi i Shkollës Fillore “Mustafa Bakija” Gjakovë datë 05 nëntor 2021 që vlejnjë për të gjitha

paditëset, ku pas vlerësimit veç e veç të secilës provë dhe duke u bazuar në lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetohet se kërkesëpadia e precizuar e paditëseve, është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Me Kontratën e punës datë 01 shtator 2016 leg.nr.1873/2021 datë 21 gusht 2021, për paditësen V. B. u vërtetua fakti se paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurën – Shkolla Filllore “Mustafa Bakija” Gjakovë, vendi i punës: mësimdhënëse e mësimit klasor, me kohëzgjatje të kontratës nga data 01 shtator 2016 të përhershme. Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e cila i referohet muajit mars 2021, vërteton rrethanën se këtu paditësja realizon pagë primare mujore neto në lartësi prej 449.74 euro dhe ka 12 vite përvojë pune.

Me Kontratën e punës datë 01 shtator 2015 leg.nr.1227/2021 datë 03 mars 2021, për paditësen V.V. u vërtetua fakti se paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurën – Shkolla Filllore “Yll Morina” Gjakovë, vendi i punës: mësimdhënëse e mësimit klasor, me kohëzgjatje të kontratës nga data 01 shtator 2015 të përhershme. Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e cila i referohet muajit mars 2021, vërteton rrethanën se këtu paditësja realizon pagë primare mujore neto në lartësi prej 460.12 euro dhe ka 26 vite përvojë pune.

Me Kontratën e punës datë 01 shtator 2016 leg.nr.1199/2021 datë 30 mars 2021, për paditësen V. H. u vërtetua fakti se paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurën – Shkolla Filllore “Mustafa Bakija” Gjakovë, vendi i punës: mësimdhënëse e mësimit klasor, me kohëzgjatje të kontratës nga data 01 shtator 2016 të përhershme. Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e cila i referohet muajit mars 2021, vërteton rrethanën se këtu paditësja V. Z. realizon pagë primare mujore neto në lartësi prej 490.93 euro dhe ka 35 vite përvojë pune. Gjykata duke u nisur nga fakti se Kontratën e punës mësimdhënësjë Valbone Hana e ka lidh në vitin 2016, ndërsa letërnjoftimi i saj lëshuar datë 05 mars 2020 dhe nga lista e pagave u vërtetua se kemi të bëjmë me V. Z., pra të njëjtin person që ka lidh kontratën e punës mbështetur në numrin personal të njëjtës, datën e lindjes ashtu siç është në letërnjoftim dhe listën e pagave.

Vërtetimi i lëshuar nga Shkolla Filllore “Mustafa Bakija” Gjakovë datë 05 nëntor 2021, provon faktin se këtu paditëset prej datës 21 nëntor 2019 deri me 05 nëntor 2021, konform kalendarëve zyrtar të MASHT, si dhe duke zbatuar vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pandeminë Covid -19, gjatë periudhës 12 mars 2020 deri më 14 shtator 2020 nuk është mbajtur mësimi fizik, ashtu që mësim kanë mbajtur 274 ditë punë, që nga data 29 nëntor 2019 deri 11 mars 2020, për 62 ditë pune, 14 shtator 2020 deri me 02 korrik 2021 për 180 ditë pune si dhe 27 shtator 2021 deri 05 nëntor 2021 për 32 ditë pune. Nga këto 274 ditë pune paditëset V. B., V. V dhe V. Z. kanë punuar pa ndërprere për gjithsejtë 274 ditë pune dhe nuk kanë pas asnjë ditë pushim.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, datë 18 prill 2017 dhe Kontratën e datës 22 janar 2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”, ashtu që duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të punësuarve në vend punimin – objektin ku kanë punuar këtu paditëset), në kontratat e sipër

elaboruara ku është vërtetuar fakti se këtu tre paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHF “Mustafa Bakija” në Gjakovë, si dhe në vërtetimin e lëshuar nga ajo shkollë me datë 05 nëntor 2021, i cili ka provuar rrethanën se këtu paditëset 29 nëntor 2019 deri më 05 nëntor 2021, në institucionin e lartcekur kanë punuar 274 ditë pune, erdhi në përfundim se kërkesa e precizuar e paditësve (për një kompensim të këtillë) është e bazuar, për çka vendosi si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19 qershor 2012 (i cili është në implementim nga data 20 dhjetor 2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëseve, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e ushqimit në punë që ka pasur ndaj këtu paditëseve, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, paditësve iu takon edhe kamata e gjykuar ashtu siç është aprovuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditëseve iu pranuan shpenzimet siç vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma 20.00 euro, për përpilimin e padisë shuma 208.00 euro, dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditëseve në shqyrtimin përgatitor, shuma 270.40 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme 498.40 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 867/2021, me 20 dhjetor 2021

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada - Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:120475
Datë: 20.12.2021
Numri i dokumentit: 02528748